

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6295
E martë, 20 prill 2021
çmimi 0.40 €

Pjetër Shala: Akuzat e Speciales, qesharake

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TETË VJET NGA MARRËVESHJA E PARË E PARIMEVE PËR NORMALIZIMIN
E MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

ANALISTËT: ASOCIACIONI DO TË DOMINOJË NË RAUNDIN E RI TË DIALOGUT

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se rëndësia e marrëveshjes së 19 prillit e nënshkruar në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë qëndron në faktin se ajo u hapi rrugë marrëveshjeve të tjera në mes të dy vendeve. Në tetëvjetorin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ata kanë bërë me dije se në raundin e ri të dialogut do të dominojë çështja e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, kjo temë do të jetë sfidë edhe për qeverinë e re



KUVENDI I KOSOVËS PRITET TË BËHET ME RREGULLORE TË RE

FAQE 3



MACRONI I SHKRUAN OSMANIT: TË VAZHDOHET DIALOGU ME SERBINË

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

DIALOGU DHE PENGJET POLITIKE NË HAGË

F. 8

Artan
BEHRAMI



AKTUALE



AMBASADORI AMERIKAN KONFIRMON MBËSHTETJEN PËR SEKTORIN E ARSIMIT

F. 8

EDHE 14 TË VDEKUR DHE 277 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 8



EKONOMI



SHEFI I BE-së: QEVERIA TË MARRË MASA KONKRETE PËR T'I TËRHEQUR INVESTITORËT E HUAJ

F. 9

SPORT

THEMELOHET SUPERLIGA EVROPIANE, KUNDËRSHTOHET NGA UEFA DHE FIFA

F. 10

Blinkeni: Kërcënimi nga terrorizmi është zhvendosur nga Afganistani

WASHINGTON, 19 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, e mbrojti vendimin e ShBA-së për t'i tërhequr trupat nga Afganistani, duke thënë se kërcënimet nga terrorizmi janë zhvendosur gjetë dhe se ShBA-ja duhet t'i përqendrojë "energjitë dhe burimet e saj" në çështje të tjera të rëndësishme si pandemia Covid-19 dhe ndryshimet klimatike. "Kërcënimi i terrorizmit është zhvendosur në vende të tjera dhe ne kemi çështje të tjera, shumë të rëndësishme, në agjendën tonë", tha Blinken për

televizionin ABC. Presidenti amerikan Joe Biden njoftoi më 14 prill se Shtetet e Bashkuara do t'i tërheqin të gjitha forcat e tyre nga Afganistani para 11 shtatorit. Tërheqja vjen pavarësisht prej bllokimit të bisedimeve të paqes midis qeverisë afgane dhe grupit militant të talibanëve. Kundërshtarët e tërheqjes amerikane këtë vit thonë se ky veprim mund ta zhysë Afganistanin më thellë në dhunë dhe t'i lërë Shtetet e Bashkuara më të cenueshme ndaj kërcënimeve terroriste.

Shtetet e Bashkuara aktualisht kanë rreth 2 500 trupa në Afganistan. NATO-ja njoftoi se 7 000 ushtarët e saj joamerikanë në Afganistan do të largohen po ashtu nga ky vend, brenda disa muajsh. NATO, e udhëhequr nga ShBA-ja, ka ndërhyrë ushtarakisht në Afganistan në vitin 2001, pak javë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në ShBA. Që nga ajo kohë mbi 2 300 ushtarë amerikanë kanë humbur jetën në luftën në Afganistan.



Zvicra dhe Portugalia i lehtësojnë masat kundër koronavirusit



CYRËH, 19 PRILL - Zvicra nisi të hënën lehtësimin e masave kundër koronavirusit, edhe pse numri i të infektuarve është në rritje. Baret dhe restorantet do të mund t'i rihapin tarracat, ndërsa palestret dhe kinematë mund ta rifillojnë punën për aq kohë sa i respektojnë masat e sigurisë. Mësimi në disa universitete do të nisë po ashtu. Zvicra është vendi i vetëm në

Evropë që lehtëson masat e izolimit, derisa numri i rasteve me koronavirus rritet. Qeveria thotë se ky veprim është i justifikueshëm sepse numri i rasteve po rritet ngadalë, procesi i vaksinimit po përshpejtohet dhe spitalet nuk janë të mbingarkuara. Zvicra, vend me 8.5 milionë banorë, ka regjistruar mbi 632 000 raste me koronavirus dhe mbi 10 500 viktima. Në Portugali, ndërkaq, qendrat

tregtare u rihapën sot, për herë të parë në dy muaj. Nxënësit, po ashtu, u kthyen në shkollë, ndërsa kafenetë dhe restorantet mund t'u shërbejnë konsumatorëve në tarraca. Para dy muajsh Portugalia ka qenë në mesin e vendeve më të goditura në Evropë. Në total ky vend me 10.2 milionë banorë ka regjistruar mbi 830 000 raste me koronavirus dhe mbi 16 900 viktima.

Rusia hakmerret, dëbon 20 diplomatë çekë

Moskë, 19 prill - Rusia ka njoftuar se do të dëbojë 20 diplomatë nga Republika Çeke, pasi kjo e fundit ka dëbuar 18 diplomatë rusë të shtunën. Agjentët lokalë të inteligjencës çeke thanë se diplomatët e dëbuar janë operativë të inteligjencës ruse. Ata dyshohen për përfshirje në një shpërthim në një depo armësh në vitin 2014. Moska u dha diplomatëve çekë një ditë kohë për t'u larguar,

ndërsa Praga u dha rusëve 48 orë. Ministria e Jashtme ruse e cilësoi vendimin e çekëve si "të pashembullt" dhe si "akt armiqësor". "Me dëshirën për t'i kënaqur Shtetet e Bashkuara, pas sanksioneve të fundit të ShBA-së kundër Rusisë, autoritetet çeke madje i tejkaluan udhëzuesit e tyre", ka njoftuar ministria e Jashtme ruse. Ajo i cilësoi si të pabaza dhe absurde pretendimet e çekëve se diplomatët rusë janë

operativë të inteligjencës. Shpërthimi në një depo armësh në qytezën Vërbitice të Çekisë ndodhi më 16 tetor të vitit 2014. Trupat e pajetë të dy punonjësve të depos, njëri 56 dhe tjetri 69 vjeç, u gjetën më shumë se një muaj më vonë. Shpërthimi fillimisht supozohej se ishte aksident. Por, detektivët çekë drejtuan në fundjavë gishtin kah Moska dhe Njësia 29155 e Agjencisë ruse të Inteligjencës GRU.



Pesë të plagosur si pasojë e sulmit me thikë në një xhami në Tiranë



TIRANË, 19 PRILL - Pesë persona kanë mbetur të plagosur nga një sulm me thikë në xhaminë "Dine Hoxha" në Tiranë. Policia ka arrestuar autorin. Ngjarja ndodhi të hënën, kur Rudolf Nikolli, 34 vjeçar, sulmoi me thikë brenda xhamisë në kryeqytet pesë besimtarë teksa ata po kryenin faljen.

Të plagosurit janë dërguar në spital dhe janë jashtë rrezikut për jetën. Imami Ahmed Kalaja ka pohuar përmes një videoje në "Facebook" se në mesin e të plagosurve kishte dhe punonjës të xhamisë. Sulmi me thikë në xhaminë e rrugës së Kavajës ndodhi në

muajin kur besimtarët myslimanë agjërojnë Ramazanin, një muaj i shenjtë për ta. Bëhet me dije se Nikolli ka qenë në kërkim nga policia për një sulm, gjithashtu me thikë, ndodhur në muajin mars në terminalin e autobusëve në Tiranë.

Macroni i shkruan Osmanit: Të vazhdohet dialogu me Serbinë

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letër urimi nga presidenti francez Emmanuel Macron, i cili nëpërmjet saj ka shprehur gatishmërinë e shtetit të tij për ta mbështetur më tej Kosovën.

Presidenti francez në letrën e urimit ka theksuar se mirëpret angazhimin e presidentes Osmani për forcimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Franca qëndron përkrah shtetit tuaj për ta ndihmuar atë për përballimin e sfidave të saj, duke filluar

me luftën kundër pandemisë. Franca së shpejti do t'i dorëzojë Kosovës 15 mijë teste antigjenike për t'u përgjigjur nevojave urgjente", thuhet në telegramin e presidentit Macron.

Më tej, presidenti francez ka theksuar se marrëdhëniet dypalëshe do të vazhdojnë të forcohen më tutje.

Macron ka përmendur edhe dialogun e Kosovës me Serbinë, duke inkurajuar vazhdimin e tij drejt një marrëveshje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërishme të detyrueshme.



Kuvendi i Kosovës pritet të bëhet me rregullore të re

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 PRILL - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt, në të cilën është marrë vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores së re të Kuvendit. Në këtë mbledhje është shqyrtuar e më pas miratuar Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit NR. 04/L-123 të Procedurës Penale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091, i cili do të përcillet në një nga seancat e radhës të Kuvendit, me rekomandimin për shmangie nga procedurat e rregullta. Po ashtu, është marrë vendim për formimin e grupit për

përgatitjen e tekstit të konkursit për zgjedhjen e dy anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe një anëtar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues i shoqërisë civile, në përbërje nga një anëtar nga grupi parlamentar.

Nga ky komision, Hydajet Hyseni është caktuar anëtar në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të dënuarve dhe të ish të përndjekurve politikë, kurse Blerta Deliu-Kodra është caktuar anëtare në Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Në lidhje me rregulloren e re të Kuvendit ka folur shefi i Grupit Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, i cili ka kërkuar që kjo rregullore të shtyhet përpara dhe procesi të



ketë një afat kohor. Ai në këtë mbledhje ka theksuar se nuk ka logjikë që Kuvendi i Kosovës të mos mund ta ndryshojë që nëntë vjet rregulloren.

Tahiri ka sugjeruar që Rregulloja e Kuvendit ta reflektojë kontekstin e Kosovës. Ai ka thënë se rregullorja në fjalë duhet ta lehtësojë punën

e Kuvendit dhe jo ta pengojë. Tahiri ka mirëpritur angazhimin e shoqërisë civile për kontributin e tyre me ndihmë profesionale në këtë drejtim.

Kush vjen nga Greqia e Maqedonia në Shqipëri do të rrijë dy javë në karantinë

TIRANË, 19 PRILL (ER) - Komiteti i ekspertëve në Shqipëri, duke parë situatën në rajon rreth situatës me Covid-19, ka vendosur që çdo qytetar që vjen nga Greqia dhe Maqedonia do të rrijë në karantinë dy javë. "Ka filluar të ndihet edhe efekti i vaksinimit, por në rajon situata është ndryshe, në Maqedoni dhe Greqi është shtuar numri i rasteve dhe jetëve të humbura. Sfidë e Komitetit është përmirësimi i indikatorëve që të propozojmë masa. Mosrespektimi i masave në

fushatë mund të ndikojë në rritje, po ashtu edhe pashkët, që kanë lëvizje të shtuar të njerëzve. Duke pasur situatën tonë, mendojmë që nga nesër qëndrim në karantinë dy javë për ata që vijnë nga Greqia dhe Maqedonia. Nxënësit e vitit të parë dhe të dytë që kanë qenë në mësim online, mund ta fillojnë mësimin në klasë. Shifrat e përmirësuara tregojnë se drita po duket, por ende kemi rrugë. Subjektet politike të tregohen të përgjegjshme", ka thënë kryetarja e Komitetit Teknik për Covid-19, Mira Rakacolli.



TETË VJET NGA MARRËVESHJA E PARË E PARIMEVE PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SERBI

Analistët: Asociacioni do të dominojë në raundin e ri të dialogut

Njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë bërë me dije se rëndësia e marrëveshjes së 19 prillit të nënshkruar në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë qëndron në faktin se ajo i hapi rrugë arritjes së marrëveshjeve të tjera në mes të dy vendeve. Në tetëvjetorin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ata kanë bërë me dije se raundin e ri të dialogut do ta dominojë çështja e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Sipas tyre, kjo temë do të jetë sfidë edhe për qeverinë e re

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 PRILL - Rëndësia e marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi është e madhe sepse ka hapur mundësinë që këto dy shtete të nënshkruajnë edhe marrëveshje të tjera. Kështu kanë vlerësuar njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi në tetëvjetorin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Ata kanë bërë me dije se sfidë për qeverinë e re do të jetë marrëveshja për themelimin Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe e cila derivon nga marrëveshje e 19 prillit.


Arbër Fetahu, hulumtues në Grupin për Studime Juridike dhe Politike, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se ky dokument përfaqëson një marrëveshje kornizë që përbëhet nga një grup çështjesh. "Më 19 prill 2013 kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë nënshkruan marrëveshjen e parë për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. Ajo përfaqëson një marrëveshje kornizë, e përbërë nga një grup çështjesh, të cilat më vonë u detajuan në marrëveshje dhe plane veprimi të ndara. Shikuar objektivisht si formë, kjo marrëveshje ka rëndësi të madhe pasi për herë të parë hapi shtigje që në mes të Kosovës dhe Serbisë të arrihen marrëveshje të ndryshme si ajo për drejtësinë, marrëveshja për sigurinë, ajo për targarë të tjera", ka thënë ai.

Fetahu ka treguar se pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje e gjithë vëmendja ka rënë te themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Por, pavarësisht prej çështjeve të tjera që dolën nga marrëveshja e parë e parimeve, vëmendja dhe

fokusi ra te marrëveshja për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. Kjo marrëveshje është marrëveshja kryesore që edhe e ka determinuar rrjedhën e dialogut përgjatë viteve. Me rastin e shpalljes së shumë elementeve të saj si jokushtetues, ajo është shndërruar në pikë ndarëse e jo si pikë referimi për normalizim marrëdhëniesh në mes dy shteteve. Andaj rëndësia si tërësi e marrëveshjes së parë është zvenitur nga këta faktorë të përmendur" është shprehur ai. Fetahu ka bërë me dije se çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe do ta determinojë edhe raundin e ri të negociatave Kosovë - Serbinë i cili pritet të fillojë së shpejti. "Marrëveshja për asociacionin mbetet një nga marrëveshjet

e paimplementuara të dala nga dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, zbatimi i saj duket mjaft i vështirë dhe, siç duket, do të dominojë edhe në raundin e ri të negociatave me Serbinë. Në përgjithësi, kjo marrëveshje, për aq sa hapi horizonte të reja dhe shënoi një moment të konsideruar 'historik', po aq krijoi kriza tutje në marrëdhëniet në mes dy vendeve", ka thënë Fetahu.

Në tetëvjetorin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Instituti Demokratik i Kosovës ka nxjerrë një raport në të cilin flet për zbatueshmërinë e saj. Sipas raportit, deri më tani janë zbatuar shtatë pika të kësaj marrëveshjeje, dy pika janë zbatuar pjesërisht dhe gjashtë të tjera nuk janë zbatuar. "Nga marrëveshja e 19 prillit kanë derivuar edhe një sërë marrëveshjes të tjera të dialogut për çështje si mbledhja e të hyrave doganore, energjia, telekom, drejtësia, shpërbërja e



mbrojtjes civile dhe asociacioni. Kjo e fundit është edhe çështja kryesore e Marrëveshjes së 19 prillit e cila ende mbetet e pazbatuar. Që nga arritja e marrëveshjes specifike për këtë temë në gusht të vitit 2015 dhe aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese, qeveritë e njëpasnjëshme në Kosovë kanë ndërmarrë hapa për zbatimin e kësaj marrëveshjeje", është thënë në raport.

Sipas raportit, ish-qeveria e udhëhequr nga Isa Mustafa kishte krijuar ekipin menaxhues në vitin 2016, i cili kishte për detyrë hartimin e statutit të Asociacionit. "Pasi statuti nuk ishte përfunduar gjatë asaj periudhe, qeveria pasardhëse e udhëhequr nga Ramush Haradinaj sërish kishte aktivizuar këtë ekip. Njoftimet zyrtare të kësaj qeverie kanë qenë se ekipi nuk ka dorëzuar statutin në qeveri dhe se nuk dihet nëse i është dorëzuar Brukselit. Çështja

e asociacionit është riaktualizuar si temë edhe gjatë qeverisë së udhëhequr nga Avdullah Hoti. Pas takimeve të mbajtura në Bruksel në kuadër të diskutimeve mbi elementet e marrëveshjes finale Kosovë-Serbi, pala serbe kishte kërkuar që çështja e asociacionit të diskutohet, ndërsa pala e Kosovës nuk kishte pranuar një gjë të tillë", është thënë në raportit.

Kurse Bashkimi Evropian si lehtësues i procesit të dialogut kishte kërkuar që Kosova të gjejë modalitete për themelimin e asociacionit duke mos qartësuar se çfarë do të thotë saktësisht kjo. Me rënien e qeverisë Hoti në fund të vitit 2020 mbeti e paqartë se si do të procedohej më tutje kjo çështje. Ndërsa pas zgjedhjeve të reja qeveria e re tani udhëhiqet nga kryeministri Albin Kurti. "Ky i fundit nuk e ka bërë të qartë se cila do të jetë qasja e qeverisë ndaj dialogut në përgjithësi, përveçse ka deklaruar

se do të jetë një qasje ndryshe ndaj këtij procesi dhe se dialogu nuk është prioritet i qytetarëve. Është e qartë që tema e dialogut do të jetë sfidë edhe për qeverinë e re e cila sa më parë duhet të artikulojë një qëndrim të qartë ndaj temave të dialogut dhe marrëveshjeve tashmë të arritura, duke përfshirë edhe marrëveshjen e 19 prillit e cila është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës", është thënë në raport. Tri vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova nisi dialogun teknik me Serbinë.

Më 8 mars të vitit 2011 u mbajt takimi i parë mes të dyja vendeve, për të pasuar me shumë të tjerë, me mbi 30 marrëveshje të arritura, shumica e të cilave nuk kanë gjetur zbatim as pas 10 vjetësh negociata. Procesi i dialogut i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian ka nisur pas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB).

Pjetër Shala: Akuzat e Speciales, qesharake

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Pjetër Shala, është paraqitur për herë të parë të hënën para Gjykatës Speciale. Shala i quajti qesharake aktakuzat ndaj tij, pasi u pyet nga gjykatësi Nicolas Guillou se nëse i ka kuptuar akuzat të cilat i ngarkohen. "Po, i nderuar, i kuptova. Qesharake më duken",

ka thënë Shala.

Ai ka thënë se nuk ka pasur nevojë të bëhet arrestimi, mjaftonte vetëm një ftesë dhe, siç tha ai, do të paraqitej vetë. "Nuk ka pasur nevojë të bëhet arrestimi dhe ky farë filmi. Vetëm një ftesë dhe unë vij paraqitem vetë", ka thënë Shala.

Më pas, Shala është deklaruar i pafajshëm lidhur me akuzat.

"Unë nuk e ndiej veten se kam bërë ndonjë krim, përveçse kam mbrojtur atdheun tim dhe popullin tim dhe ndihem i pafajshëm", është shprehur Shala.

Pjetër Shala u arrestua më 16 mars 2021 nga autoritetet belge dhe u transferua në Hagë më 15 prill 2021 në bazë të një kërkesë për bashkëpunim në zbatimin e

fletarrestimit dhe urdhrat për transferim lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Në aktakuzën e konfirmuar Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në forma të ndryshme për krime lufte si ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur

jondërkombëtar në Kosovë dhe në lidhje me këtë konflikt.

Siç njofton Specialja, krimet për të cilat akuzohet Shala u kryen përafërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës (Shqipëri), që pretendohet se përdorej nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.



Kurti kërkon nga Sllovakia ta njohë Kosovën



PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të hënën në takim shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë në Kosovë, Rastislav Kostilnik. Në takim Kurti ka kërkuar që Sllovakia ta njohë Kosovën. "Kryeministri Kurti e falënderoi z. Kostilnik për vizitën dhe për mbështetjen për

liberalizimin e vizave për Kosovën dhe i bëri thirrje Sllovakisë që ta shtyjë përpara këtë vendim sa më shpejtë për qytetarët e Kosovës. Po ashtu, kryeministri Kurti shprehu interesimin për zgjerimin e thellimit të bashkëpunimit bilateral mes dy vendeve dhe i kërkoj Sllovakisë që t'i bashkohet

grupit të BE-së që e njeh Kosovën. Kryeministri Kurti mirëpriti interesimin e Sllovakisë për dialogun dhe theksoi se ai duhet të jetë i mirëpërgatitur, me një qasje transatlantike dhe transformative, i udhëhequr nga vlerat demokratike. Ai theksoi edhe faktin që Sllovakia si vend anëtar i

NATO-s dhe i BE-së mund të mbështesë dhe të shtyjë përpara anëtarësimin e Kosovës në aleancën veriatlantike si dhe kërkoj mbështetjen për anëtarësim në organizata ndërkombëtare", ka njoftuar qeveria.

Sipas këtij njoftimi, shefi i Zyrës

Ndërlidhëse i Republikës së Sllovakisë në Kosovë, Kostilnik, ka falënderuar Kurtin për pritjen dhe ka shprehur vullnetin për vazhdim të bashkëpunimit bilateral. Ai ka theksuar gatishmërinë e Sllovakisë për mbështetje në fushën e sundimit të ligjit dhe të ekonomisë.

Haziri: Duhet të kemi kujdes maksimal sepse Covidi nuk është larguar

GJILAN, 19 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, në takimin e mbajtur sot të kryesuar nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vlerësuar gjendjen e përgjithshme të përballjes me pandeminë Covid-19 dhe procesin e vaksinimit. Kryetari Haziri ka kërkuar respektimin e rekomandimeve të IKShPK-së dhe në bazë të vlerësimeve të fundit del se prej 19 534 mostrave të marra deri më tani, 668 qytetarë të kësaj komune janë aktualisht pozitivë. "Edhe pas vlerësimeve të fundit që sot kemi bërë të përballjes me pandeminë dhe procesin e vaksinimit del se me gjendje më të rëndë janë 80 qytetarë të shtruar në spitalin regional, por kronika e zezë

është vështirësia më e madhe që e kemi në këtë rrugë të vështirë, kur nga jeta ndahen qytetarët tanë dhe numri i tyre, deri më tani është gjithsej 131 të vdekur. Solidarizohemi me të gjitha familjet që kanë humbur jetën. Edhe Komiteti i Emergjencave në Gjilan ka humbur një anëtar të vetin, Ymer Demollin, i angazhuar 24 orë dhe shtatë ditë për ta parandaluar Covidin por, fatkeqësisht, ai nuk është më në mesin tonë", ka thënë Haziri në konferencën për media të së hënës. Ai ka apeluar që qytetarët e Gjilanit të kenë një kujdes dhe përkushtim të madh në ruajtje të distancës sociale, higjienës personale pasi, siç ka thënë, nuk është larguar virusi. "Vaksinimi nuk nënkupton që familja apo personi shpëton nga



infeksioni, por duhet vazhdimisht të jemi të kujdesshëm karshi respektimit të masave të reja të cilat janë më të lira dhe shpresojmë që kujdesi edhe

më tutje të jetë në nivelin më të lartë", ka shtuar Haziri. Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 19 534 mostra, 6 068 kanë

rezultuar pozitivë, 5 279 janë shëruar, 131 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 668 raste janë aktive dhe të hospitalizuar me Covid janë 79 persona.

Përurohet objekti i shkollës "Habib Berisha" në Gurbardh



MALISHEVË, 19 PRILL (ER) - Të hënën është bërë përuimi i objektit të ri të shkollës "Habib Berisha" në fshatin Gurbardh të Komunës së Malishevës. Tanimë kjo shkollë do ta fillojë mbajtjen e mësimin në një ndërrim. Në ceremoninë e përuimit të objektit të shkollës morën pjesë familjarët e dëshmorit të kombit Habib Berisha, emrin e të cilit mban shkolla, nënkryetari i Komunës së

Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, drejtorë të drejtorive komunale, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, dhe mesimdhënësit e kësaj shkolle. Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i ka uruar të gjithë mesimdhënësit dhe nxënësit për objektin e ri. "Ky objekt dhe kjo shkollë tashmë do të

mbajë mësimin në një ndërrim dhe iu bashkohet objekteve të tjera shkollore në komunën tonë, ku mësimi mbahet në një ndërrim. Ne gradualisht kemi krijuar hapësirën e nevojshme për të gjitha shkollat, që mësimi të mbahet në një ndërrim. Për ndërtimin e kësaj shkolle dhe të gjitha shkollave të tjera, padyshim që më meritori është kryetari i komunës, Ragip Begaj", ka thënë Berisha.

Bedri Maqastena emërohet drejtor i Inspeksionit në Podujevë

PODUJEVË, 19 PRILL (ER) - Me vendim të kryetarit të Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, të hënën Bedri Maqastena është emëruar drejtor i Inspeksionit në këtë komunë. Emërimi i Maqastenës është bërë pas kërkesës të drejtorit të deritashëm Ajet Potera për t'u liruar

nga detyra për shkak të angazhimeve të tjera. Kryetari Bulliqi ka falënderuar Ajet Poterën për kontributin e tij në dikasterin e Inspeksionit për këta katër muaj, kurse Bedri Maqastenës i ka uruar suksese në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë së tij.



TIKA dhuron 230 pako ushqimore për familjet në nevojë

Prishtinë, 19 prill (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) të hënën ka dhuruar 230 pako ushqimore dhe 70

pako higjienike për familjet në nevojë. "Falënderojmë TIKA-n për solidaritetin dhe mbështetjen e vazhdueshme për qytetarët e Prishtinës", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Në kulmin e represionit në fillim të viteve '90, dialogu shqiptarëve u shërbeu si mjet demokratik për ta kundërshtuar dhunën e regjimit të Serbisë.

Dialogu u bë arma e vetme e rinisë studentore dhe Anton Çettës për ta vrarë urrejtjen, për t'i pajtuar gjaqet, për ta ndaluar vëllavrasjen, për ta rizbuluar armikun e vërtetë të shqiptarëve - Serbinë.

Dialogu për pajtim, bashkë me popullin e Kosovës, u shndërrua në kauzë kombëtare duke larguar rrezikun e vrasjes së njëri-tjetrit dhe duke u konvertuar në një luftë mbrojtëse për njëri-tjetrin.

Edhe kur shtypja u bë e padurueshme, e papërballueshme, kur vrasjet, dhunimet dhe përndjekjet masivizoheshin, ne, shqiptarët, sërish besuam në dialog.

Dialogu ishte gjithmonë opsioni ynë i parë edhe në luftën tonë për çlirim. Në Rambuje, Kosova shkoi e bashkuar, derisa delegacionin për dialog e udhëhoqi UÇK-ja ata që udhëhoqën luftën çlirimtare.

Unike!

Dialogu na solli lirinë, na solli edhe pavarësinë. Dialogu ishte orientimi ynë perëndimor-ajo që na açikoi në Ballkanin Perëndimor.

Ka pak shoqëri në botë që nga një fjali e vetme kanë nxjerrë kaq shumë domethënie!

Ka pak shoqëri në botë që një fjalë të vetme e kanë shndërruar në kauzë kaq të gjatë, një herë në mbijetesë, më pas në kauzë të çlirimit, të pavarësisë dhe të shtetndërtimit.

Por, nuk ishte vetëm dëshira jonë për dialog ajo që përcaktoi triumfet tona-ishin edhe momentumet historike, ishin rrethanat gjeopolitike.

Thjesht, ishte një botë tjetër!

Në botën e këndejeve multipolare, të pandemisë, të riorientimit të interesave gjeopolitike, Kosova duhet të mendojë gjatë e mirë çdo hap në politikën e Jashtme.

Tash e disa vjet dialogu është kthyer kokëposhtë, është bërë sinonim i numërimit të ditëve, të javëve, të muajve, të vjetëve dhe i dekadës së status-quo.

Biden e ka Kosovën në zemër, por jo në agjendë

Ne i kemi humbur momentumet gjeopolitike për të përfunduar dialogun me Serbinë, kur në fuqi ishin miqtë e vërtetë të Kosovës, në një botë pa pandemi, pa recesion, pa konflikte të hapura, pa një Rusi dhe Kinë agresive.

Merkel tashmë i takon historisë, derisa presidenti amerikan, Joe Biden, nuk do t'i përmbushë pritshmëritë tona-ato pritshmëritë e një Kosove që ende beson se është kërthiza e



Shkruan: Artan BEHRAMI

Dialogu dhe pengjet politike në Hagë

globit.

Biden e ka në zemër e në mendje Kosovën dhe ka një marrëdhënie emocionale me popullin tonë, porse përcaktimi i prioriteteve të politikës së Jashtme në SHBA nuk udhëhiqet nga ndjenjat, por nga interesat shtetërore.

Si rrjedhojë, presidentët amerikanë janë të operuar nga ndjesitë personale.

Në javët e ardhshme do të bëheni dëshmitarë se presidenti Biden do të ketë prioritete tjera të politikës së Jashtme.

Ai do të vazhdojë të na urojë për Bajram, për Ditën e Pavarësisë. Patjetër që do të delegojë edhe një përfaqësues për dialog nga Departamenti i Shtetit.

Përkundër dëshirës, ai nuk do të ketë kohë që të merret seriozisht me zgjidhjen e problemeve shekullore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë!

Ukraina, përballimi me pandeminë, rimëkëmbja ekonomike dhe vatra tjera të konflikteve në botë do t'ia marrin vëmendjen presidentit Biden.

Kosovën, njëjtë si Obama dikur, do t'ia lë në duar evropianëve.

Kështu, Kosovën e presin katër vjet të status-quo në politikën e Jashtme, ku aktivizimit amerikan mund t'i paraprijë vetëm ndonjë konflikt i armatosur, që mund ta trazojë strukturën e sigurisë në Evropë. Amerika nuk ka simpati për Kosovën pse ne jemi populli më proamerikan dhe më besnik në botë, por Kosovën e sheh vetëm nga perspektiva e stabilitetit të Evropës.

Në duart e Borrellit dhe të Lajçakut

E braktisur përkohësisht nga Amerika, Kosovën e presin katër vjet të tjera të status-quo! Të zbritur në tokën evropiane, neve na pret një proces i gjatë i dialogut Kosovë-Serbi, një serial i Netflix-it me 9 sezone përplot dramë dhe pa përfundim.

BE-ja edhe më tutje dëshiron të investojë në status-quo, duke shpresuar që në vitin 2050 të vijë një gjeneratë me mentalitet skandinav në Kosovë e në Serbi dhe t'i zgjidhë problemet e shtresuara tash e disa shekuj në Ballkan me shtypje të gjakut

90/60.

Dialogu Kosovë-Serbi për shumë kohë i ka shërbyer ruajtjes së status-quo, duke i arsytuar politikën e BE-së të stagnimit të Zgjerimit.

Gjasat që Kosova anëtarësohet në BE në dekadën e ardhshme janë më të vogla sesa vaksinimi i popullatës së Kosovës nga Qeveria Kurti brenda muajit prill.

Ne duhet të pajtohemi që Bashkimi Evropian ka nevojë për një paraderë, të cilës mund t'ia vendosë perdet e hekurta sa herë që dëshiron të mos e shohë mjerimin.

Aty ku SHBA-ja nuk ka rol udhëheqës në procesin e dialogut, aty nuk ka sukses në dialog.

Në këtë rrugë na prin një BE, e cila që nga viti 2010, në mënyrë sistematike, i ka gënjer elitat politike në Kosovë për liberalizim të vizave, për njohje nga pesë shtetet dhe për perspektivë evropiane.

Me gjasë Kurti do të jetë kryeministri i parë i Kosovës, i cili duket se nuk do të ketë presion të madh ndërkombëtar për të hyrë në dialog, sidomos nga Shtetet e Bashkuara të

Amerikës.

Duke e njohur Albinin, ai do t'i rezistojë presionit ndërkombëtar. Kështu, ai fare nuk ka nevojë t'i mbysë iniciativat ndërkombëtare për dialog me akte kamikazësh, qysh e kishte bërë në të kaluarën.

Dialogu me Serbinë Kosovës i ka kushtuar shumë energji, shumë para, shumë fokus. Është një luftë e përditshme, e përhershme.

Serbia e ka shumë të lehtë të navigojë edhe në dialog, edhe në status-quo. Ekonomia dhe politika e saj e Jashtme i ecën shumë mirë edhe pa Kosovën, meqë 'kancerin' e ka jashtë trupit të saj.

Por, kësaj radhe do ta ketë edhe më lehtë nëse hyn në dialog. Serbia është në kulmin e relativizimit të krimeve të veta, të ndryshimit të narracionit dhe të historisë.

Për të jetësuar këtë, Serbia të gjitha shpresat i ka vendosur në një kryeqytet të Evropës ku, deri më sot, asnjëherë nuk e shpalli atë fajtorë për gjenocid, ku asnjëherë krimet e saj ndaj shqiptarëve nuk u gjykuan.

Në Hagë, ku 400 masakra në Kosovë, spastrimi etnik, dëbimi i rreth një milion qytetarëve, dhunimi i mbi 20 mijë grave asnjëherë nuk u gjykua.

Ata që e udhëhoqën dialogun po mbahen peng në Hagë

Liderët kryesorë politikë që kanë bartë barrën e luftës, të lirisë, të pavarësisë dhe të dialogut me Serbinë që sot mbahen padrejtësisht në Hagë, nesër mund të përdoren si pengje politike në një proces të dialogut.

Procesi i Gjykatës Speciale e vendos Kosovën në një pozicion shumë të vështirë përballë një Serbie, e cila tash e dy dekada i mohon të gjitha krimet në Kosovë.

Në këto rrethana, ulja në një tavolinë me Serbinë do të ishte gabim strategjik, me pasoja afatgjate për Kosovën.

Vuçiqi, i cili mohon masakrën e Reçakut, masakrën më vizuale që ndonjëherë ka regjistruar bota e shekullit XX, paramendojeni me çfarë halucinacionesh do të shkojë në takime të dialogut për krerët e UÇK-së.

Shkuarja e krerëve të UÇK-së në Hagë ka krijuar një krater brenda Kosovës, dhe pa gravitetin e tyre politik do të jetë vështirë të arrihet një marrëveshje historike me Serbinë.

Kryeministri Kurti edhe mund ta provojë, por me një këmbë në dialog e me një tjetër në jetësimin e premtimeve që i ka dhënë, do të jetë një 'shpagë' e pamundur.

Edhe 14 të vdekur dhe 277 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 PRILL - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 047 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 277

raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Podujevë tri raste (80, 75, 73 vjeç), Deçan një rast (58 vjeç), Gjakovë një rast (67 vjeç), Gjilan një rast (76 vjeç), Lipjan një rast (74 vjeç), Mitrovicë një rast (78 vjeç), Obiliq një rast (63 vjeç), Prishtinë një rast (69 vjeç), Prizren një rast (66 vjeç), Shtime një rast (66 vjeç), Suharekë një rast (83 vjeç), Viti një rast (83 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 101 794 raste nga 502 159 persona të dyshimtë me këtë



virus dhe 2086 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 411 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të

shëruarve deri më sot është gjithsej 87 423 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 285.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 97 raste, Ferizaj 32 raste, Gjakovë 21 raste, Mitrovicë 20 raste, Pejë 20 raste, Fushë-Kosovë 14 raste, Gjilan 12 raste, Klinë 12 raste, Podujevë 11 raste, Vushtrri 9 raste, Lipjan 4 raste, Deçan 3 raste, Drenas 3 raste, Kamenicë 3 raste, Prizren 3 raste, Viti 3 raste, Rahovec 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Hani i Elezit, Obiliq, Shtime, Shtërpçë dhe Suharekë.

Kardiokirurgë nga Amerika dhe Italia do të kryejnë intervenime në 30 fëmijë me probleme në zemër

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 19 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, kanë vizituar Klinikën Pediatrike në QKUK, me rastin e fillimit të misionit të shoqatës ndërkombëtare "Gift of Life" për trajtimin karidokirurgjik të fëmijëve të Kosovës.

Presidentja Osmani ka shprehur falënderimin për stafin mjekësor për kontributin e vazhdueshëm dhënë në këtë kohë të pandemisë. "Faleminderit për gjithçka që kenë bërë, sepse tash gjatë pandemisë nuk është e lehtë. Ju po rrezikoni jetët tuaja dhe të familjarëve tuaj nga ndonjë infeksion i mundshëm. Por, kjo kurrë nuk do të harrohet. Do të jemi përjetësisht falënderues",



ka deklaruar Osmani. Organizata "Gift of Life" vitin e kaluar kishte planifikuar rreth 90 operime në Kosovë, por i

anuloi ato për shkak të situatës me pandeminë.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka çmuar lart punën e

jashtëzakonshme të kësaj organizate që për vite me radhë realizon misione të tilla ku, përveç që po ndihmon fëmijët,

janë duke kontribuar shumë edhe për edukimin e vazhdueshëm profesional të stafit mjekësor vendor. "Jam këtu për ta shprehur mirënjohjen, gjithashtu për t'ju treguar juve që ne jemi këtu për ta bërë gjithçka të mundur. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar juve. Faleminderit dhe shpresojmë për projekte të ardhshme. Shpresojmë për më shumë jetë të shpëtuar", ka thënë Vitia.

Drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, duke njoftuar rreth angazhimit për organizimin e këtij misioni ka sqaruar se një ekip i përbërë nga 17 ekspertë kardiokirurgë amerikanë dhe italianë, të asistuar nga mjekët vendorë, do të kryejnë intervenime në 30 fëmijë me probleme në zemër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ambasadori amerikan konfirmon mbështetjen për sektorin e arsimit

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Specifika të rëndësishme për arsimin në Kosovë u diskutuan gjatë takimit që ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci dhe zëvendësministri Dukagjin Pupovci, patën me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett.

Ministrja Nagavci e ka njoftuar ambasadorin Kosnett për programin qeverisës ku, sipas saj, objekt strategjik i tij janë të gjitha fushat e arsimit në Kosovë. Në këtë takim u shpreh vullnet për bashkëpunim që nga vlerësimi formativ e deri te ndërlikdhja e arsimit me tregun e punës, duke përmendur këtu inkuadrimitin e ish-bursistëve të

mbështetur nga Qeveria amerikane.

Ambasadori Kosnett ka theksuar se Qeveria amerikane e mbështet zotimin e Qeverisë së Kosovës që në pozita të rëndësishme të vendosen persona të kualifikuar. Po ashtu, Kosnett e ka cilësuar të nevojshëm edhe krijimin e programeve për mësimin e gjuhëve të komuniteteve.

Në takim u diskutua edhe për funksionalizimin e Bordit të KShC-së, ku Nagavci ka siguruar se procedura do të jetë transparente. Ambasadori Kosnett në këtë takim është shprehur i gatshëm për bashkëpunim të afërt në të ardhmen në fushat që janë me rëndësi për zhvillimin e vendit.



Shefi i BE-së: Qeveria të marrë masa konkrete për t'i tërhequr investitorët e huaj

Në pesëvjetorin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) u tha se kjo marrëveshje ndihmon Kosovën që ta forcojë demokracinë dhe të ketë stabilitet institucional, ndërkaq ajo çfarë mbetet për t'u bërë është forcimi i legjislacionit. Po ashtu, u theksua se Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa konkrete për t'i tërhequr investitorët e huaj

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 PRILL - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomash Szunyog, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa konkrete për t'i tërhequr investitorët e huaj. Në konferencën e Këshillit të Investitorëve Evropianë të mbajtur me rastin e pesëvjetorit

të hyrjes në fuqi të MSA-së, Szunyog ka vlerësuar se kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme për Kosovën dhe për BE-në. "Qeveria duhet të marrë masa konkrete për t'i tërhequr investitorët huaj. Është një marrëveshje e rëndësishme për Kosovën dhe BE-në. Marrëveshja ndihmon Kosovën që ta forcojë demokracinë dhe të ketë institucione stabile.

Marrëveshja ndihmon Kosovën në shumë sektorë", ka deklaruar Szunyog.

Kurse zëvendëskryeministri Besnik Bislimi ka deklaruar se qeveria Kurti fokus e ka luftën kundër pandemisë, pa lënë anash edhe rimëkëmbjen ekonomike. "Qytetarët e kanë thënë fjalën e tyre, dëshirojnë më shumë punë, drejtësi, rënie të varfërisë, ruajtje të ambientit etj.,

po ashtu edhe qasje më të lehtë për bizneset e tyre. Dhe, po ashtu, më pak korrupsion dhe krim të organizuar", ka thënë Bislimi.

Drejtori i Bordit të Këshillit të Investitorëve, Visar Ramajli, ka theksuar se implementimi i MSA-së është interes kombëtar, andaj është i nevojshëm bashkëpunimi i sektorit privat dhe i institucioneve shtetërore. Ramajli ka theksuar që konkurrenca nuk mund të realizohet brenda natës ndërsa, sipas tij, duhet të përgatiten bizneset dhe ekonominë që të jenë konkurruese në mënyrë që t'i bashkohemi BE-së.

Robert Wright, i cili ka në emër të sektorit bankar, ka thënë se marrëveshja që nga hyrja në fuqi

ka pasur ndikim në sektorin financiar.

MSA-ja përcakton kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me vendet anëtare dhe institucionet e BE-së për zbatimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (SAP) deri në anëtarësimin e plotë në BE.

Sa i përket fushës, përveç çështjeve politike dhe detyrimeve ligjore (përfshirë ato që ndikojnë në rendin e brendshëm ligjor), MSA-ja mbulon të gjitha fushat e qeverisjes.

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg dhe hyri në fuqi më 1 prill 2016.




Gjendja e biznesit në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, e pakënaqshme

PRISHTINË, 19 PRILL (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se gjendja e biznesit në tremujorin e katërt 2020 është e pakënaqshme, përkatësisht rreth 45 për qind e bizneseve kanë vlerësuar se kanë një gjendje jo të kënaqshme biznese. Megjithatë, ai ka pohuar se në krahasim me tremujorin paraprak, gjendja e biznesit ka shënuar një përmirësim të lehtë, pasi përqindja e bizneseve që vlerësojnë situatën aktuale si të pakënaqshme është më e vogël. Rukiqi ka thënë se përderisa në TM4 të vitit 2019, 23 për qind e kompanive respodente prisnin

rritje të numrit punëtorëve, në TM4 të vitit 2020, janë vetëm rreth 12 për qind e kompanive që kanë pritje pozitive, pra ka një rënie të pritshmërive prej 11 pritje pozitive.

Rukiqi në konferencën për media ka thënë se rreth 1/4 e kompanive të intervistuar presin që ta mbajnë numrin e njëjtë të punëtorëve në tre muajt e ardhshëm. "Pritjet për gjashtëmujorin e ardhshëm janë pothuajse të ngjashme me TM4, rreth 41 për qind e kompanive respodente kanë vlerësuar se situata e tyre biznese në gjashtë muajt e ardhshëm do të përmirësohet", ka thënë Rukiqi.





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Themelohet Superliga Evropiane, kundërshtohet nga UEFA dhe FIFA

MADRID, 19 PRILL - 12 klube të mëdha në Kontinent kanë themeluar brenda natës Superligën e Evropës pavarësisht prej kërcënimeve të UEFA-s, FIFA-s dhe ligave kombëtare: "12 klube prestigjioze të futbollit evropian sot, së bashku, shpallën një marrëveshje për të krijuar një kampionat të ri futbollit, Superligë, e drejtuar nga klubet themeluese, që janë si më poshtë: Milan, Arsenal, Atletico Madrid, Chelsea, Barcelona, Inter, Juventus, Liverpool, Manchester City, Manchester United, Real Madrid dhe Tottenham Hotspur janë bashkuar si klubet themeluese. Tri klube të tjera pritet të bashkohen si klube themeluese përpara sezonit përurues, i cili duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur", thuhet në njoftimin. "Duke menduar për të ardhmen, klubet themeluese shpresojnë t'i vazhdojnë bisedimet me UEFA-n dhe FIFA-n për kërkim të zgjidhjeve më të mira për Superligën dhe për futbollin botëror në tërësi. Krijimi i ligës së re vjen kur pandemia globale ka përshtetur paqëndrueshmërinë e modelit aktual ekonomik të futbollit evropian. Për vite me radhë klubet themeluese kanë synuar ta përmirësojnë cilësinë dhe intensitetin e garave ekzistuese



evropiane dhe, në veçanti, të krijojnë një turne në të cilin mund të garojnë klubet dhe lojtarët më të mirë". Superliga Evropiane do të financohet nga JP Morgan, një kompani e madhe financiare në Amerikë. "Reuters" shkruan se ky grup me seli në Nju-Jork ka konfirmuar me një e-mail se do ta financojë Superligën Evropiane. Sipas një hulumtimi, klubet pjesëmarrëse do të mund të përfitojnë rreth 3.5 miliardë euro. Klubi që do ta fitojë Superligën do të përfitojë 400 milionë euro, 280 më shumë

krahasuar me shumën që përfitohet nga suksesi i mundshëm në Ligën e Kampionëve (arkëton maksimumi 120 milionë euro). 585 milionë mund të përfitohen në bazë të rezultateve, ndërsa pagesa fillestare për çdo klub do të jetë 488 milionë euro. Ende nuk dihet se si do të operohet me të drejtat televizive, por pritet që të gjenerohen rreth 10 miliardë euro në krahasim me 4.5 miliardë që gjeneron Liga e Kampionëve. Lajmi për krijimin e Super Ligës së Evropës në mënyrë të pashmangshme

shkaktoi alarm në UEFA, e cila reagoi pak orë para vendimit të 12 klubeve për ta njoftuar zyrtarisht lindjen e kompeticionit të ri. UEFA dhe ligat evropiane kanë konfirmuar përmes një deklarate të përbashkët, se janë të gatshme të përjashtojnë nga garat kombëtare dhe ndërkombëtare të gjitha ekipet e përfshira në projektin e Superligës. Gjithashtu, lojtarëve të këtyre klubeve do t'u ndalohej grumbullimi me ekipet kombëtare. Një deklaratë e vërtetë lufte për klubet e

përfshira në krijimin e Superligës.

Cili është formati dhe kur fillon Superliga Evropiane

Superliga Evropiane u formua zyrtarisht të dielën pas mesnatës nga 12 klube të mëdha evropiane dhe gara mund të fillojë hiç më larg se në gusht të këtij viti. Liga do t'i ketë 20 klube pjesëmarrëse, 15 prej të cilave do të jenë klube themeluese dhe të përhershme në ligë. Pesë ekipe të tjera do të kualifikohen për këtë garë çdo vit bazuar në arritjet e tyre në sezonin paraprak. Ndeshjet do të zhvillohen në mesjavë, në mënyrë që klubeve t'iu mundësohet të luajnë në ligat e veta vendore, për ta mbrojtur kalendarin tradicional të ndeshjeve në ligat vendore. Liga do të fillojë në gusht çdo vit dhe do t'i ketë dy grupe me nga 10 ekipe. Ndeshjet në fazën grupore do të zhvillohen vajtje-ardhje. Tri ekipet e para në grup kualifikohen automatikisht në çerekfinale. Ekipet që përfundojnë në vendet katër dhe pesë do të takohen në një "play-off" me dy ndeshje për vendet e mbetura çerekfinale. Më pas do të përdoret një format eliminimi direkt me dy ndeshje për ta arritur finalen në fund të majit, njëlloji si në Ligën e Kampionëve që e njohin sot.

Sot zhvillohen çerekfinalja e dytë, Peja dhe Bashkimi në epërsi



PRISHTINË, 19 PRILL - Sot (e martë) do të zhvillohen ndeshjet e dyta çerekfinale të "play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Sigal Prishtina dhe Peja do të përballen sërish. Pejanët e fituan bindshëm takimin e parë 106-77 dhe do të përpiqen ta fitojnë edhe ndeshjen e dytë për të kaluar në gjysmëfinale, ku i pret Ponte

Prizreni, derisa prishtinasit do të përpiqen ta barazojnë rezultatin në 1-1. Takim më dramatik ishte mes Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit, ku prizrenasit fituan pas vazhdimit 79-94. Nëse fitojnë prizrenasit edhe në ndeshjen e dytë, do të kualifikohen në gjysmëfinale, ku i pret Rahoveci, ndërsa skuadra therandase do të

mundohet të barazojë shifrat në 1-1. Skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale. Ponte Prizreni dhe Rahoveci janë kualifikuar drejtpërdrejt në gjysmëfinale.

TË MARTËN TAKOHEN:

17:00 Sigal Prishtina - Peja
20:15 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

Superliga do të thotë të heqësh dorë nga historia 70-vjeçare e futbollit evropian

MANCHESTER, 19 PRILL - Ish-trajner i Manchester United, Sir Alex Ferguson, është kundër krijimit të Superligës së Evropës. Ferguson ka thënë se kjo do ta dëmtojë futbollin. Sipas tij kjo do të thotë që të hiqet dorë nga historia 70-vjeçare e futbollit evropian, raporton "The

Sun". "Superliga do të thotë të heqësh dorë nga historia 70-vjeçare e futbollit evropian. Nga trajner i Aberdeensit për të fituar Ligën e Kampionëve (Ish-Kupa e Kupave të cilën e kishte fituar në vitin 1983) ishte si të ngjisësh Malin Everest. Evertoni tani po shpenzon 500 milionë

euro me ambicien që të luajë në Ligën e Kampionëve, tifozët e duan Ligën e Kampionëve ashtu siç është", ka thënë Ferguson. "Kam qenë pjesë e katër finaleve dhe ishin netët më speciale. Manchester United? Nuk bëj pjesë e këtij diskutimi", ka shtuar Ferguson.



Ulpianës i dorëzohet Kupa e kampionit të Ligës së Parë

ULPIANË, 19 PRILL - Ulpiana e Lipjanit është kampione e Ligës së Parë të Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Ulpiana ka mbledhur 24 pikë, duke i

fituar të gjitha 12 ndeshjet në edicionin 2020\2021. Ulpiana në edicionin e ardhshëm do të luajë në Superligën e Kosovës në hendboll.

Kupa për skuadrën kampione është dorëzuar të dielën në një ceremoni të mbajtur në palestrën në Lipjan. Po ashtu, janë dorëzuar medaljet për lojtaret e Ulpianës. Kupën

dhe medaljet i kanë dorëzuar Fitim Arifi, ushtrues i detyrës i drejtorit të Departamentit të Sportit dhe Komisari i Garave, Istref Sadriu. (Ismail Rexhepi)



FFK-ja: Nuk do të lejojë më dëmtimin e mbarëvajtjes së garave dhe prishjen e imazhit të futbollit

PRISHTINË, 19 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës ka reaguar lidhur me dhunën në një ndeshje të Ligës së Parë dhe në dy ndeshje të Ligës së Dytë. FFK-ja i ka parë me shqetësim incidentet e ndodhura gjatë kësaj fundjave në disa prej stadioneve dhe me këtë rast e dënon ashpër dhunën e shfaqur në ndeshjen e Ligës së Parë, Ferizaj - Ulpiana dhe në dy ndeshjet e Ligës së Dytë, Fushë-Kosova - Vjosa dhe Minatori - Behari. Për FFK-në çdo veprim i dhunshëm është i papranueshëm, pa marrë parasysh situatën dhe rrethanat. "Për FFK-në çdo veprim i dhunshëm është i papranueshëm, pa marrë parasysh situatën dhe rrethanat. Ftojme të gjitha organet dhe komisionet tona që gjatë ditëve në vazhdim t'i shqyrtojnë e t'i analizojnë në detaje ngjarjet e ndodhura këtë fundjavë dhe t'i ndërmarin masat e duhura ndaj



të gjithë të përfshirëve në këto skena të pahijshme. Po ashtu, u bëjmë thirrje edhe organeve të rendit dhe të drejtësisë që të veprojnë në parandalimin dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që shfaqin dhunë në fushat e gjelbra", thuhet në njoftimin e FFK-së. "FFK nuk do të lejojë që disa individë të papërgjegjshëm ta dëmtojnë mbarëvajtjen e garave dhe ta prishin imazhin e

mirë të futbollit tonë, të cilin e kemi krijuar me shumë mund e djersë. Njëherësh, kërkojmë edhe nga zyrtarët tanë që punën e tyre ta kryejnë me profesionalizëm e përgjegjësi për çka edhe janë të thirrur, teksa nga klubet kërkojmë organizim të mirëfilltë dhe të mos lejojnë që në stadione të ketë njerëz të tillë të pandërgjegjshëm", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Miami arrin fitore në frymën e fundit

MIAMI, 19 PRILL - Në NBA u zhvilluan tetë takime në mbrëmjen e radhës, ku nuk munguan emocionet që ofron kampionati më spektakolar i basketbollit në planet. Fitore në frymën e fundit për Miami Heat, që pas tri humbjeve radhazi triumfoi 109-107 ndaj Brooklyn Netsit. Vendimtar me koshin e fundit, para rënies së sirenës, Bam Adebayo, që rezultoi gjithashtu shënuesi më i mirë për të zotët e shtëpisë me 21 pikë, pa harruar edhe 11 "rebounde". Netsat ishin të detyruar të hiqnin dorë nga shërbimet e Kevin Durantit pas vetëm katër minutave lojë për shkak të një dëmtimi në kofshë. Siguron fitoren e gjashtë radhazi New York Knicksi, që iu imponua me rezultatin 122-112 New Orleans Pelicansit. Protagonist i takimit i zakonshmi Julius Randle, këtë herë me 33 pikë dhe 10 asistime, megjithatë nuk duhet anashkaluar ndihma e vyer që dha me 23 pikë Derrick Rose. Ndërkohë për Pelicansin nuk mjaftuan 34 pikët e Zion Williamsonit. Humbje e shëmtuar e Dallas Mavericksit që u dorëzua përballë Sacramento Kingsit me rezultatin 107-121. Kalifornianët, të cilët shkonin në këtë përballje pas një serie negative prej 9 humbjes



radhazi, u udhëhoqën nga De'Aaron Fox, autor i 30 pikëve dhe 12 "reboundeve", duke zhvlerësuar paraqitjen e Luka Donçiqit, që e mbylli përballjen me plot 37 pikë. Gjithçka e lehtë për Los Angeles Clippersin, që mposhti Minnesota Timberwolvesin 124-105. Për kalifornianët më i miri mbi parket rezultoi Paul George me 23 pikë, të njëjtën kuotë pikësh realizoi nga ana tjetër edhe Edwardsi, por që shërbyen vetëm për statistikë. Toronto Raptorsi koleksionoi fitoren e tretë radhazi, duke mposhtur Oklahoma City Thunderin 112-106. Pavarësisht prej mungesave

të shumta, kanadezët morën një sukses tjetër të rëndësishëm falë një super Chris Boucher, që realizoi "double-double": 31 pikë dhe 11 "rebounde", ndërsa 29 pikët e Luguentz Dortit nuk mundën ta shmangin humbjen e 10 radhazi të Thunderit.

REZULTATET

Atlanta - Indiana	129-117
New York - New Orleans	122-112
Miami - Brooklyn	109-107
Charlotte - Portland	109-101
Orlando - Houston	110-114
Toronto - Oklahoma	112-106
Dallas - Sacramento	107-121
LA Clippers - Minnesota	124-105

SHKURT

Egzon Shala përfaqëson Kosovën në Evropianin e Varshavës

Mundësi me normë olimpikë "Tokio 2020", Egzon Shala, do ta përfaqësojë Kosovën në Kampionatin Evropian të mundjes që po mbahet në Varshavë të Polonisë. Shala do të garojë në kategorinë deri në 125 kilogramë, stil i lirë. Në luftën e parë, që do të zhvillohet nesër (e martë), Shala përballë me polakun Kamil Tomasz Kosciolk. Egzoni prej 25 marsit deri më 15 prill është përgatitur në kampion përgatitor në Sofje të Bullgarisë, ndërsa shpenzimet i janë mbuluar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Shkarkohet Mourinho

Drejtesit e Tottenhamit e kanë shkarkuar trajnerin Jose Mourinho. Vendimi i papritur është marrë vetëm gjashtë ditë para finales së League Cup kundër Manchester Cityt në "Wembley". Ryan Mason dhe Chris Powell do të marrin frenat e skuadrës për pjesën tjetër të sezonit. Portugezi largohet nga kjo detyrë për shkak të rezultateve të dobëta. Presidenti i "Spurs", Daniel Levy, ka nisur kërkimin për një pasuesi të denjë të Mourinhos. Ndeshja e fundit e ish-trajnerit të Portos, Chelseat, Interit, Real Madridit dhe Manchester United, erdhi pas barazimit të fundit 2-2 kundër Evertonit. Mourinho ishte emëruar trajner në nëntor të vitit 2019 në vend të Mauricio Pochettinos dhe e udhëhoqi Tottenhamin drejt vendit të gjashtë në Premierligë sezonin e kaluar.

UEFA aprovon reformat e reja në Ligën e Kampionëve

UEFA ka aprovuar reformat e reja në kuadër të zgjerimit të Ligës së Kampionëve. Shtëpia evropiane e futbollit ka konfirmuar se në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-së janë aprovuar reformat e reja. Ndryshimi do të jetë që nga 32 klube do të marrin pjesë 36. Ndërsa klubet elitare që nuk arrijnë të kualifikohen nuk do të jenë pjesë e saj. Në vend të grupeve, formati i ri do të jetë në formë të Ligës. Tetë më të mirët arrijnë në fazën eliminuese dhe skuadrat e reja hyjnë në garë përmes "play-off"-it. Çdo klubi do t'i garantohet se do të zhvillojë 10 ndeshje dhe do të rriten të hyrat e klubeve.

Flick: Bayerni nuk do jetë pjesë e Superligës Evropiane

Trajneri i Bayern Munchenit, Hansi Flick, ka konfirmuar se gjiganti gjerman nuk do të bëhet pjesë e Superligës Evropiane. Flick ka konfirmuar lajmin e dhënë më parë për mediat nga drejtori sportiv i Dortmundit, Hans-Joachim Watzke, i cili konfirmoi se Dortmundi nuk do të jetë pjesë e kësaj lige. "Tani kam probleme të tjera. Nuk i di detajet e kësaj lige, por e mbështes vendimin e klubit dhe të Ligës së Kampionëve. Unë mbështes Ligën e Kampionëve. Një superligë nuk është e mirë për futbollin evropian", ka thënë Flick.

Schalke, pas 30 vjetësh, bie zyrtarisht nga Bundesliga

Pas një sezoni katastrofal, duke arritur të grumbullojë vetëm 13 pikë në 29 ndeshje, skuadra e Schalkes ka rënë zyrtarisht nga Bundesliga gjermane pas 30 vjetësh.

Schalke ndodhet në vendin e fundit në Bundesligën gjermane teksa tani ekipin gjerman nuk e mban më në lojë as matematika, ku në pesë ndeshje të mbetura në kampionat i duhet t'i marrë 15 pikë për ta kapur fazën "play-out", një mision i pamundur ky për skuadrën nga "Glesenkirshen". Pjesë e Schalkes këtë sezon ishte edhe mbrojtësi shqiptar Shkodran Mustafi, i cili u transferua në fund të merkatos së dimrit nga skuadra e Arsenalit, e ku mori jo pak kritika nga drejtuesit dhe trajneri për paraqitjet e tij të dobëta.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKAKOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, neni 67, 68 dhe 69 të Ligjit për Arsimin në Komunën e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Gjiçanit Shpall:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Në bazë vendimit të Gjykatës

Institucioni: Komuna e Gjiçanit

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit - Gjiçan;

Titulli i vendit të punës: Edukatore për Parafillorë në SHFMU "Skenderbeu" në fsh,Përlepnice.

Numri i Pozitave: Një (1);

Lloji i Pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik;

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Institucionit;

Grada/Koeficienti: Koeficienti – A-421

Orët e punës: 40 orë në javë;

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar;

Përshkrimi shkurtër i detyrave të punës:

1.Puna me fëmijë

- Organizon mësimin sipas kurrikulës së Edukimit Parashkollor dhe dokumentit të Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët e moshës 3-6 vjeç;

- Lehtëson të nxënëit e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplota dhe adekuate për moshë çdo ditë sipas orarit të caktuar në SHFMU "Skenderbeu" në Përlepnice;

- Lehtëson të nxënëit dhe zhvillimin e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplota dhe adekuate për moshë sipas orarit të caktuar në SHFMU "Skenderbeu" në Përlepnice;

- Përdor një sërë metodash që u përshtaten rrethanave dhe nevojave të fëmijës në kontekstin e pedagogjisë ndërvepruese edhe sipas UA.nr.19/2016

- Përforon lidhjet mes fushave të Kurrikulës, si dhe nxit të nxënëit e integruar;

- Në punën e përditshme me fëmijë promovon dhe integron vlerat në lidhje me të drejtat e njeriut dhe edukimin për qytetari demokratike; edukimin mbi paqen; edukimin për zhvillim të qëndrueshëm; barazinë gjinore; mirëkuptimin ndërkulturor; shkathtësitë jetësore; edukimin shëndetësore; edukimin ekonomik dhe ndërmarrës; edukimin për media; TIK-un dhe mësimin elektronik;

- Identifikon problemet/vështirësitë në të nxënëit e fëmijëve dhe ofron mbështetjen e duhur;

- Përcjell dhe dokumenton përparimin e fëmijëve duke shfrytëzuar instrumentet specifike për monitorimin dhe dokumentimin e zhvillimit të fëmijëve dhe aplikon vlerësimin formativ nga perspektiva e ofrimit të udhëzimeve, këshillave, motivimit dhe përkrahjes për fëmijët;

- Organizon dhe merr pjesë me grupin e fëmijëve në ngjarjet dhe aktivitetet kulturore të cilat organizon shkolla (programe, ekspozita, ekskursione dhe manifestime të tjera);

- Edukatore/ja është përgjegjëse/e për sigurimin e kualitetit të lartë të kujdesit dhe edukimit parafillor përmes punës së drejtpërdrejtë të saj/tij me fëmijët në grupin e saj/tij;

- Përgjegjësi për mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë fëmijëve në grup përkatës;

2.Puna me prindër

- Komunikon rregullisht me prindërit dhe mban ata të informuar në lidhje me pritjet dhe aktivitetet e programit;

- Ndanë informata me prindërit lidhur me angazhimin e fëmijëve në aktivitetet shkollore dhe marrëdhëniet sociale, suksesin dhe zhvillimin e tyre;

- Diskuton përparimin e fëmijëve me prindër dhe këshillon ata në lidhje me aktivitetet që ndihmojnë zhvillimin e fëmijëve;

- Organizimi i takimeve individuale dhe grupe me prindër në nivel grupi;

3.Puna me kolegë (bashkëpunëtorë)

- Reflektin rregullisht për punën dhe ndanë informata me kolegët lidhur me suksesin, përparimin dhe jetën e fëmijëve;

- Inkurajon diskutimin dhe bashkëpunimin midis mësimitdhënësve, komunitetit, prindërve dhe fëmijëve;

- Bashkëpunon me personelin edukativ të shkollës dhe me hierarkinë institucionale;

5.Zhvillimi Profesional

- Ndjekë trajnimet e nevojshëm që lidhen me Zhvillimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme dhe shërbimet që e mbështesin atë, të ofruara nga MASHT dhe organizatat të tjera.

- Angazhohet në punë ekipore dhe merr pjesë në komunitetet e grupeve profesionale brenda dhe jashtë institucionit përkatës;

- Në mënyrë indirekte merr pjesë në aktivitetet jashtë mësimore dhe jashtëshkollore;

- Kryen dhe punë tjera që i caktohen.

- Përgjegjës për zhvillim të përgjithshëm dhe përkujdesjes për fëmijët sipas standardeve të përcaktuara për edukim parafillor;

Kushtet dhe Kualifikimi:

Kualifikimi për mësimitdhënës : kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativet të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 8/2010,në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

Dokumentet e nevojshme:

Ekstrakti i lindjes (kopje);

Diploma e fakultetit – shkollës së lartë (kopje);

Certifikatën nga Gjykata se nuk është nën hetime (originali);

Letërnjoftimi (kopje) dhe;

Dëshminë mbi përvojën e punës

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 12.04.2021 deri me 26.04.2021

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo ti shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunes së Gjiçanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuar ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Gjiçanit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës si dhe në kolegjet private brenda Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Gjiçanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Sqarim:

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektivit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë, menjëherë pas mbylljes së konkursit.

Drejtori i DKA-së:

Nazim Gagica



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKAKOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



UPRAVA ZA OBRAZOVANJE

Na osnovu Zakona o javnim službenicima br. 06 / L-114, člana 67, 68 i 69 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br. 03 / L-068, Zakona o pred-univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, na osnovu Administrativnog uputstva (MONT) br. 10/2018 o Normativu o profesionalnom kvadru opšteg obrazovanja i na osnovu Administrativnog uputstva 07/2017 o uređivanju procedura konkursa u javnom sektoru, opština Gjilane objavljuje:

KONKURS

ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Na osnovu odluke Suda

Institucija: Opština Gjilane

Uprava: Uprava za obrazovanje - Gjilane;

Naziv radnog mesta: Vaspitačica u predškolskom OSNS "Skenderbeu" u selu Prilepnica

Broj pozicija: Jedan (1);

Vrsta pozicije: Službenik za javne usluge;

Naziv nadzornog: Direktor institucije;

Nivo/Koeficijent: Koeficijent –

Radno vreme: 40 sati sedmično;

Period ugovora: Na neodređeno vreme;

Kratak opis radnih zadataka:

1. Rad sa decom

- Organizuje nastavu u skladu sa nastavnim planom i programom za predškolsko obrazovanje i dokumentom Standardi razvoja i učenja u ranom detinjstvu za decu uzrasta 3-6 godina;
- Omogućava učenje deci uzrasta od 5-6 godina i uključuje ih u značajne i uzrastu prikladne aktivnosti svakog dana prema rasporedu utvrđenom u OSNS "Skenderbeu" u Prilepnici;
- Olakšava učenje i razvoj dece uzrasta od 3-5 godina i uključuje ih u značajne i uzrastu prilagođene aktivnosti prema rasporedu utvrđenom na OSNS "Skenderbeu" u Prilepnici.
- Koristi niz metoda koje odgovaraju okolnostima i potrebama deteta u kontekstu interaktivne pedagogije prema AU.br.19 / 2016
- Jača veze između područja kurikuluma, kao i promiče integrirano učenje;
- Promovira i integrira vrednosti koje se odnose na obrazovanje o ljudskim pravima i demokratskom građanstvu u svakodnevni rad s decom; mirovno obrazovanje; obrazovanje za održivi razvoj; rodna ravnopravnost; interkulturalno razumevanje; životne veštine; zdravstveno obrazovanje; ekonomsko i preduzetničko obrazovanje; medijsko obrazovanje; TIK i e-učenje;
- Utvrđuje probleme / poteškoće u učenju dece i pruža odgovarajuću podršku;
- Prati i dokumentuje napredak dece koristeći posebne alate za praćenje i dokumentovanje razvoja deteta i primenjuje formativnu procenu iz perspektive pružanja smernica, saveta, motivacije i podrške deci;
- Organizuje i učestvuje sa grupom dece u kulturnim događajima i aktivnostima koje organizuju škole (programi, izložbe, izleti i drugi događaji);
- Vaspitač/ica je odgovoran/a za osiguravanje visokog kvaliteta predškolske zaštite i obrazovanja kroz njen / njegov direktan rad sa decom u njenoj / njegovoj grupi;
- Odgovornost za dobrobit i sigurnost sve dece u odgovarajućoj grupi;

2. Rad sa roditeljima

- Redovno komunicira s roditeljima i informira ih o očekivanjima i aktivnostima programa;
- Deli informacije sa roditeljima o uključenosti dece u školske aktivnosti i društvenim odnosima, njihovom uspehu i razvoju;
- Diskutuje o napretku dece s roditeljima i savetuje ih o aktivnostima koje pomažu deci da se razvijaju;
- Organizovanje individualnih i grupnih sastanaka sa roditeljima na nivou grupe;

3. Rad sa kolegama (saradnicima)

- Redovno reflektuje na poslu i deli informacije sa kolegama o uspehu, napretku i životu dece;
- Potiče raspravu i saradnju između nastavnika, zajednice, roditelja i djece;
- Saraduje sa školskim osobljem i institucionalnom hijerarhijom;

4. Profesionalni razvoj

- Pohađa neophodnu obuku vezanu za rani razvoj i negu deteta i usluge koje je podržavaju, koje pružaju MONT i druge organizacije.
- Uključuje se u timski rad i učestvuje u zajednicama profesionalnih grupa unutar i izvan relevantne institucije;
- Indirektno učestvuje u vannastavnim i vanškolskim aktivnostima;
- Obavlja druge zadatke koji su mu/joj dodeljeni.
- Odgovoran/na je za opšti razvoj i brigu o deci u skladu sa utvrđenim standardima za predškolsko obrazovanje;

Uslovi i kvalifikacija:

Kvalifikacija za nastavnike: potrebna je odgovarajuća profesionalna obuka u skladu sa važećim normama MONT-a. Svim kandidatima koji su završili studije van Republike Kosova i koji se prijavljuju za ove poslove, diplome (stečene fakultetske diplome) moraju biti priznate od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije u skladu sa uputstvom MONT-a, br. 8/2010, u suprotnom će komisija tokom selekcije aplikacija odbiti svaku prijavu kandidata koji nisu ispunili ovaj uslov konkursa.

Potrebni dokumenti:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Ekstrakt rođenja (kopija);
- Diploma fakulteta/srednje škole (kopija);
- Potvrda Suda da nije pod istragom (original);
- Lična karta (kopija) i;
- Dokaz o radnom iskustvu

Dokumentacija se predaje u kopiji, jer se ne vraća nakon završetka postupka zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od 12.04.2021 do 26.04.2021.

Svi zainteresovani kandidati mogu preuzeti aplikacije u fizičkom obliku u Centru za pružanje usluga građanima ili ih mogu preuzeti sa zvanične web stranice opštine Gjilane <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> i državnog portala <https://konkursi.rks-gov.net/>, te ispunjenje predati Centru za pružanje usluga građanima u opštini Gjilane.

Na razgovor će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije i uđu u uži izbor.

Svim kandidatima koji su završili studije van Republike Kosova, kao i na privatnim koledžima u okviru Republike Kosova i koji se prijavljuju za ove pozicije, Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije mora priznati (nostrifikovati) diplome (stečene fakultetske diplome), u skladu sa Administrativnim uputstvom, broj 12/2018 od 10.09.2018, inače će komisija tokom odabira prijave odbiti svaku prijavu kandidata koji nisu ispunili ovaj uslov konkursa.

Aplikacije predate nakon isteka roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.

Rezultati se objavljuju na web stranici opštine Gjilane <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> i na linku: <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Objašnjenje:

Za ove poslove kandidati moraju polagati pismeni test. Kandidati koji tokom pismenog testa dobiju 50% bodova bit će pozvani na usmeni intervju.

O vremenu i mestu održavanja intervjua kandidati će biti informisani putem obaveštenja koje će biti objavljeno na tabelama zgrade Opštinske uprave za obrazovanje i na objektu u blizini Centra za pružanje usluga građanima, odmah po zatvaranju konkursa.

Direktor OUO-a:
Nazim Gagica



Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë përkrahje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijojnë shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti

5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!

ISBN 978-9951-780-49-0




9 789951 780490

6.99€



UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës
Drejtoria Për Arsimit dhe Edukim

Nr: 11826
Më: 10.03.2021

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, Kapitullit V nënitem 67 dhe 68, e në bazë Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratave dhe Emërimit të Përkohshme, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2019, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunale e Arsimit në Malishevë, shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Nr.	Niveli, Shkolla	Vendi	Titulli i mbiqytëresit	Lloji i pozitave	Titulli i punës	Koeficienti	Orë: në javë	Kohëzgjatja e emërimit
1	Gjimnazi "Hamdi Berisha"	Malishevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Zëvendës drejtor	7.8	40	4 (katër) vite

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e arsimit;
- Zhvillimin e një plani afatgjatë për aktivitetin e drejtorisë;
- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore;
- Aftësimin e personelit në institucion;
- Planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informimit për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës;
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në institucion;
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregulloret e komunës për arsim.

Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit,
- 1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar),
- 2. Master arsimor (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite shkollim universitar),
- 3. Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar)
- 4. Bachelor katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar),
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënëseve,
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASH, sipas rekomandimit KSHI,
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo - arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës,
- 1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë,
- 2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët në nivele tjera,
- 3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

1. Certifikata e lindjes, (kopje);
2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës, (kopje);
4. Dëshmi mbi përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor, (kopje);
5. Portofolin profesional, me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/ formularin H të këtij UA;
6. Letër referencë nga një institucion publik kredibile (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, Institucionet e Arsimit të lartë);
7. Letrat e referencës duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
8. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it,
9. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor i licencuar më të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
10. Dëshmi që nuk është nën hetime, dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët (origjinal);
11. Kopja e letërnjoftimit.
12. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standarde të praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësojnë të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës. Datë e njoftimit në web faqen: <https://kk.ks-gov.net/malisheve/kategoria/shoalliet/>, <https://kk.ks-gov.net/malisheve/> është prej dt; 10.03.2021 deri me dt, 08.04.2021, ndërsa datë e aplikimit është nga dt; 09.04.2021 deri me dt; 23.04.2021. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen nga Komisioni, ndërsa në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që janë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë

selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushte të konkursit.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://kk.ks-gov.net/malisheve/kategoria/shoalliet/konkurset/>

Malishevë: 10.03.2021 Drejtori i Arsimit

Elvira Thopi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Flamur Duriqi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- Ibrahim Shkreta shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Mati Logoreci" Prizren.
- Zymer Fetahi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Bajram Curi" Romajë.
- Suad Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat shfmu "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- Zejnulla Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat shfmu "Heronjtë e Lumes" Vermicë.
- Elza Mustafi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Ekrem Rexha" Gencare.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 15.04.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, U.d. Kryeshefi Ekzekutiv me datë 19.04.2021, **SHPALLË:**

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit (1 punëtor):

II. Numri i referencës: NPL -D.T. 19/4/2021:

III. Detvat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP. ZPP përveç obligimeve tjera ka përgjegjësi në vijim: a) Në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit. Kur është e mundur mundshme siguron që artikujt e përdorimit të zakonshëm janë konsoliduar; b) Siguron që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efektive dhe efektive; c) Për aq sa mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë; d) Këshillon njësitë kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit; e) Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, specifikimet, Te Parametat dhe Paralogaritë dhe vizatimet; f) Organizon dhe menaxhon aktivitetet e prokurimit; g) Rekomandon përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve; h) Partecipon në Negocime të Tenderëve dhe siguron rezultate të drejta; i) Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shqyrton propozimin për kontratë të rekomanduar nga komisioni vlerësues; j) Pranon/refuzon rekomandimin e propozuar; k) Nënshkruan kontratat pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht; l) Kur ndodhin mosmarrëveshje, dëme në mallra, dorëzime të tepërta ose të mangëta, dështim në performim ose komplikime tjera relevante, ruan të gjitha komunikimet dhe dështimet relevante të pranuar; m) Përcjellë dështimet e kontraktoreve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuale kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave; n) Prodhon një raport vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara. n) Kryen punë dhe detyra të urdhëruar nga Mbiqëqyrsi.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera.
- Certifikata e mjekut,
- Certifikata se keni zotësi të veprimit,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata e lindjes,
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

- Diploma Universitare e noterizuar;
- Certifikatë valide, bazike apo të avancuar të prokurimit e noterizuar;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;
- Njohuria obligative e kompjuterit.

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mblylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data e publikimit.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “BOHREX” SH.P.K. me pronar Ferid Berisha, ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811033480 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa “BOHREX” D.O.O. Ferid Berisha, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811033480, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “BOHREX” L.L.C. Ferid Berisha, has come to the decision to quit its nr. 811033480, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët tanë se Kompania ‘NES & MALI - Metal’ SH.P.K.

Me seli në Prizren ka marrë vendim ta shuaj biznezin, me nr të regjistrimit:
810084575

Dhe ka caktuar lekuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit, Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore- Debitorë në këtë shoqëri të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë

OBAVESTENJE

Obavjestavamo sve klijente da Tvrtka ‘NES & MALI - Metal’ SH.P.K.’ u Prizren doneo odluku da ugasi biznez po br.registra: 810084575 I ujedno imenavo likuidatora o sprovodenju postuaka likfidacija. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navendenoj frimi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all our customers that the company ‘NES & MALI - Metal’ SH.P.K.

Based in Prizren, it has decided to close the business, with registration number:
810084575

And has appointed the liquidator for the development of the Liquidation procedure, All clients who have Credit-Debit reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË